



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 21.

Prishtinë, më 28.10.2011 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Agim Kuleta

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KKK- Avnija Bahtijari, Veton Berisha, përfaqësues EUSR Visar Bivolaku, përfaqësues USEP Maja Markovic, përfaqësuesit nga ICO Suzana Saljih. M. Montic, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, me raportin e Komisionit funksional për Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti, dhe Industri. me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshje ndërkombëtare nr. 04/L-52, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Përfundimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Të ndryshme

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë të votave.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 27.09.2011, 29.09.2011 dhe të datës 10.10.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, me raportin e Komisionit funksional për Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti , dhe Industri. me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, të propozuara nga Komisioni Funksional.

Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-48 për tregti me jashtë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshje ndërkombëtare nr. 04/L-52, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit për marrëveshje ndërkombëtare nr. 04/L-52, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit për marrëveshje ndërkombëtare nr. 04/L-52 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Përfundimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,

Kryesuesi – Me theks të veçantë tha se Komisioni për këtë takim ka ftuar kryetarin e Komisionit për Legjislacion z, Arben Gashi, dhe i njëjti nuk iu është përgjigjur ftesës ton. Për përafrimin e qëndrimeve tona lidhur me këtë Projektligj fjalën ia dha përfaqësuesit të KKK.

Avnija Bahtijari – në emër të KKK është mirënjohës për pjesëmarrjen e cila është dakorduar të ketë një diskutim konstruktiv mbi opinionet tona në ndryshimin ose jo në përbërjen e KKK.

Ai theksoi si përfaqësues i Këshillit ka marr pjesë në grupin punues ndërministrorë kur janë bërë ndryshimet dhe plotësimet Ligjit.

Në grupin punues ndërministror, qeveria dhe KKK-ja janë akorduar se qëllimi i vetëm i ndryshimit të ligjit për komunitete është që statusi i komuniteti kroat dhe atij malazez të jenë të njohura në mënyrë eksplicite me këtë Projektligj.

Sa i përket amendamenteve të propozuara nga grupi 6+ dhe njëherit të përkrahura nga komisioni funksional për komunitete, do të bëjnë të detyrueshëm që me përjashtim të Kroatëve dhe Malazezëve prej 30 % deri 50 % e anëtarëve të KKK nga komunitetet tjera të jenë deputet të Kuvendit të Kosovës.

Ai theksoi se KKK nuk pajtohet me raportin me rekomandime të komisionit Funksional, komisionit për Komunitete dhe Kthim, për këto arsye.

Në bazë të parimeve të ndarjes së pushteteve funksionojnë në bazë legjislationit, ekzekutivit dhe gjyqësia të cilat janë parimet bazë dhe shtyllë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parimi që i njëjti person, përfaqësues i njëjtë politikë, duhet të zënë të gjitha pozitat nuk është një parim i mirë për Kushtetutën dhe për pozitën e komuniteteve.

Së dyti, theksoi se janë votuesit tuaj ata që janë duke kërkuar prej jush të jeni të përgjegjshëm dhe të merrni shqetësimet dhe kërkesat e tyre legjitime në konsideratë sot kur do të votoni për këtë ndryshim. Përfaqësues të shoqërisë civile anëtarë të KKK-s, përfaqësojnë organizatat përfaqësuese të komuniteteve, ata janë një pjesë e zgjedhësve tuaj pikërisht ata votues ju i përfaqësoni në pushtetin legjislativ. Anëtarët e shoqërisë civile të KKK-s, janë duke kërkuar që ju të përqendroheni në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në fushën legjislative dhe ata kërkojnë që ju të ngitni zërin e komuniteteve para pushtetit ekzekutiv.

Kjo është fryma e ligjit mbi komunitetet dhe ne si KKK apelojmë që mos të ndryshohet një frymë të tillë.

Petar Miletic- shprehu qëndrimin e tij se deputetët nuk janë obligues të jenë pjesëtar në KKK.

Ai theksoi se partitë politike dëshirojnë të jenë pranishme në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, Duke u bazuar në esenca e demokracisë, ne jemi përfaqësues të cilët kemi dalë me programet tona, gjithashtu jemi zgjedhur nga qytetarët e Kosovës.

Në anën tjetër ekziston problemi rreth emërimit të anëtarëve të trupit në KKK . siç janë organizatat joqeveritare Mund të thuhet se anëtarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, nuk janë të përfaqësuar në Këshill, andaj ka dilemë si do të rregullohet statusi i tyre.

Sa i përket Komisionit për Legjislation, ata nuk kanë paraqitur rekomandim të duhur dhe të qartë. por është dashur të ofrojë vlerësimin e tyre lidhur me amendamentin e dhënë nga grupi 6+, se sa është në përputhshmëri me legjislationin, e jo të kërkohej që komisioni Parlamentar të takohet me KKK dhe ti përfaqësojë qëndrimet tona.

Në fund theksoi se është obliguese Kryetarja e Presidencës të deklarohej për trupin e KKK, andaj Komisioni nuk do të kishte dilemat e saja.

Ai deklarohej se përkrah amendamentin e grupit 6 +. me konstatim se komisioni funksional është përgjegjës dhe se do të dalë me Raport përfundimtar të Projektligjit.

Goran Marinkovic- nga përfaqësuesit e KKK, ai kërkoi sqarim lidhur me Përfundimin e nxor nga Këshilli: deputeti i Kuvendit të Kosovës të jetë anëtar i obliguar i KKK është në kundërshtim me natyrën e përmbajtjes së ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Avnija Bahtijari – ai dha sqarim se lidhur me amendamentin e propozuar nga grupi 6+ që deputeti duhet të jetë anëtar i Këshillit, me këtë rast iu merret autonomia organizatave të cilat janë të akredituara në zyrën e Presidencës.

Anëtarët e KKK-s nga shoqëria civile thonë se nuk kanë asgjë kundër autonomisë së Organizatave Përfaqësuese të Komuniteteve në rast se ato vendosin që të emërojnë një deputet të Parlamentit ose përfaqësues politik si përfaqësuesi të tyre në Këshill. Ata vetëm duan të mbrojnë autonominë e Organizatave përfaqësuese të Komuniteteve për të zgjedhur nëse ndonjë anëtarë të Parlamentit ose përfaqësuesve politike duhet të përfaqësojnë një komunitet në KKK ose jo.

Kjo është ajo që kërkon ligji aktual për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Mufera Sinik – me theks të veçantë tha se grupi punues 6+ ka dhënë propozim e vet ku i njëjti është miratuar si amendament i komisionit funksional. Ajo dha sqarim se me ndryshimin e fjalës ‘duhet të jetë’ rregullohet edhe anëtarësimi i përfaqësuesve në KKK.

Sa i përket Raportit me rekomandime i dal nga komisioni janë është miratuar nga komisionet tjera të përhershme përveç Komisionit për legjislacion andaj kërkoi që kjo çështje të rregullohet sa më par.

Rasim Demiri- u ndërlidh me fjalimin e z, Petrovic kush ua ka dhënë autoritetin- legalitetin përfaqësuesve në KKK. Mendon se ata nuk e kanë marrë votën e qytetarit. Ai shtoi se në Kuvend janë përfaqësuesit e partive të zgjedhur nga populli. Sa i përket komunitetit kroat dhe malazez do të jenë të inkorporuar me Projektligj.

Etem Arifi- mendon se kjo mënyrë e diskutimeve, paraqet një pasqyrë se jemi neglizhencë, me arsyetim se ky Projektligj është i përpiluar mirë dhe nuk ka nevojë të ketë pengesa për procedim të mëtutjeshëm. Përkundër të gjitha fakteve, kërkoi që Komisioni të miratoi amendamentet e propozuara nga ky komisioni dhe se i njëjti të miratohet në Kuvend.

Lumnije Morina – tha se Ligji për Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, ka ardhur nga Qeveria me plotësim dhe ndryshim që në Këshill Konsultativ të jenë të përfshirë përfaqësuesit e komunitetit kroat dhe atij malazez. me ç’rast këto dy komunitete do ti fitojnë kompetencat e tyre si përfaqësues në Këshill.

Ajo mendon që sot Komisioni duhet të precizojë qëndrimin e vet dhe njëherit pajtohet me propozimin e grupit punues 6 +. dhe më pas Projektligji të procedohet për Seancë Plenare.

Albert Kinolli – në fjalinë e tij tha se komisioni me shumicë të votave ka miratuar amendamentet e grupit 6+, andaj propozoi që i njëjti Raport të procedohet për miratim në Kuvend.

Myfera Sinik –plotësisht i përmbahet qëndrimit, se amendamenti 3, është më se i nevojshëm që të inkorporohet në raport përfundimtar në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Në bazë të diskutimeve të shumta, lidhur me amendamentet e propozuara të Komisionit, si Komision raportues dhe Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Komunitete dhe Kthim me shumicë të votave miratoi dhe ka konfirmuar amendamentet si Komision Funksional në Projektligj , si në vijim:

Amendamenti 1

Të behët harmonizimi i tekstit të projektligjit, versioni në gjuhën serbe dhe angleze, me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 2

Neni 1. fshihet

Amendamenti 3

Neni 3. Paragrafi 12.6 riformulohet si vijon:

12.6 „Këshillin Konsultativ për Komunitete e përbëjnë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të Qeverisë së Kosovës; të Zyrës së Presidentit dhe të institucioneve tjera të rëndësishme.

Komuniteti Malazez dhe Kroat, në Këshillin Konsultativ, do të kenë nga 2 (dy) përfaqësues.

Komuniteti Rom, Egjiptas, Ashkali dhe Goran do të kenë nga dy (2) përfaqësues, prej të cilëve një (1) duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti Turk dhe Boshnjak i kanë nga (3) tre përfaqësues prej të cilëve një (1) duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti serb i ka pesë (5) përfaqësues, prej të cilëve dy (2) duhet të jenë deputetë të Kuvendit të Kosovës ”

Për secilin anëtar, mund të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zakonisht kryesues apo zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

Në bazë të konsultimeve të shumta, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe kthim mur qëndrim që mbledhja të shtyhet për një javë dhe u vendos që në takim të ftohet përfaqësuesit nga zyra e Kryeministrit me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme, këshillimeve, mendimit dhe sugjerimeve të tyre lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Mbledhja do të mbahet në ditën e hënë, më 10 tetor 2011, prej orës 11:00, në sallën N-302, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic